



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 2811<sub>1</sub> prot.

Tiranë, më 18 . 02 .2026

Lënda: Njoftim dhe kërkesë për informacion

**SHOQËRISË "TOP CHANNEL" SH.A (NIPT/NUIS K12007002U)**  
**TELEVIZIONIT KOMBËTAR TOP CHANNEL**  
**PROGRAMI BIG BROTHER ALBANIA VIP**  
Rruga "17 Nëntori", Nr. 20, Mëzez Kodër, Kashar  
Tiranë

**Z. ROBERT STERKAJ**

Pjesmarrës në Programin Big Brother Albania Vip, Televizioni Kombëtar Top Channel  
Rruga "17 Nëntori", Nr. 20, Mëzez Kodër, Kashar  
Tiranë

**Për dijeni: FONTACIONIT SË BASHKU**  
Rruga "Dritan Hoxha", Blloku "Gintash", Objekti nr.2, Zyra nr.14 1023  
Tiranë

Bazuar në nenin 32/1/b dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 38, datë 05.02.2026, e paraqitur nga Fondacioni Së Bashku kundër Top Channel, Big Brother Albania Vip, z. Rogert Sterkaj, pjesmarrës në programin Big Brother Albania Vip, në Televizionin Kombëtar Top Channel, me pretendimin për diskriminim për shkak të "*aftësisë së kufizuar*".

Në ankesën e paraqitur pranë Komisioneri, pala ankuese parashtron:

Më 3 shkurt, në padite, gjatë programit Big Brother Albania Vip, të transmetuar në Top Channel kundër gazetarit Stenaldo Mehilli, u përdor gjuhë urrejtje nga një pjesmarrës tjetër në program, z. Rogert Sterkaj. Një gjuhë e tillë është e rrezikshme për dinjitetin dhe të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara, sepse duke marrë parasysh audiencën e gjerë të programit, ajo

përforcon stereotipet dhe stigmën ekzistuese ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe ndikon në të gjithë komunitetin e personave me aftësi të kufizuara duke dërguar mesazhin se jeta e personave me aftësi të kufizuara është më pak e denjë për t'u jetuar sesa e atyre pa aftësi të kufizuara.

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri njohjen e diskriminimit, përjashtimin e pjesmarrësit dhe kërkesë falje publike.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në pikën 8, të nenit 3, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.”*

Bazuar në nenin 5, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ka parashikuar në nenin 7/1 se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Përsa më lart, ju njoftojmë se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi po ndjek të gjithë hapat e parashikuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, neni 33, pika 7, ku përcaktohet : “7. Me regjistrimin e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve pune nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër.” dhe neni 32, pika 2, ku parashikohet: “2. Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”, **kërkojmë nga ana juaj që të paraqisni:**

- Parashtrime me shkrim mbi pretendimet e palës ankuese, si dhe çdo shpjegim apo informacion që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
- Televizioni Top Channel, duhet të depozitojë pranë Komisionerit materialin video të datës 03.02.2026 ku janë bërë deklaratat nga pjesmarrësi z. Rogert Sterkaj gjatë programit Big Brother Albania Vip.

Sa më sipër është kërkuar, duhet të depozitohet pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga marrja dijeni për këtë njoftim.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,



The image shows a circular official stamp in blue ink. The text around the perimeter of the stamp reads "REPUBLIKA E SHQIPËRIE" at the top, "KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI" in the middle, and "TIRANË" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink, which appears to be "Robert Gajda".

